



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Mars 2021

Nr: 182

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALLAKASTËR, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË DEMOKRACIA SOCIALE,  
ZJ. NATIRDA DRITAN ALIAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ**

Me shkresën nr. 1744 prot., datë 03.08.2020, këshilli i bashkisë Mallakastër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari zj. Blerina Tofik Alushaj, propozuar nga subjekti partia Demokracia Sociale.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e partisë Demokracia Sociale, për këshillin e bashkisë Mallakastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 12, zj. Eliona Pajtim Brakaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 911 prot., datë 04.02.2021 ka njoftuar zj. Eliona Pajtim Brakaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Zj. Eliona Pajtim Brakaj, nuk e ka depozituar formularin e vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, brenda afatit ligjor.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vijoi procedurën me kandidatin vijues nga lista shumemërore e partisë Demokracia Sociale, përkatësisht me kandidatin me numër rendor 14, zj. Natirda Dritan Aliaj.

Me shkresën nr. 1411 prot., datë 23.02.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, zj. Natirda Dritan Aliaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit partia Demokracia Sociale, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 017 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Natirda Dritan Aliaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, rezulton se, se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 1727 prot., datë 05.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1726 prot., datë 05.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Natirda Dritan Aliaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, zj. Natirda Dritan Aliaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 2462/1 prot., datë 09.03.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Natirda Dritan Aliaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pika 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidati për anëtar zj. Natirda Dritan Aliaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

## **V E N D O S:**

1. Zj. Natirda Dritan Aliaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë Demokracia Sociale, zj. Natirda Dritan Aliaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 29 Mars

Nr. 182

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokracia Sociale, zj. Natirda Dritan Aliaj